



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:157140
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07027523

P.nr.808/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Dardan Tolaj, në çështjen penale kundër të pandehurit Shpëtim (D.) Smajli nga P., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale „Kanosja” nga neni 181 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjë PP/II.nr.1939/2020 të dt.12.11.2020, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar datë 11.02.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal Demhasaj, të pandehurit Shpëtim Smajli dhe të dëmtuarit Nebih Zariqi, mori dhe publikisht shpalli me datë 13.02.2025, ndërsa me datë 07.03.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

SHPËTIM SMAJLI, i atësisë D. i amësisë A. e gjinisë Q., i lindur me dt. në P., ku edhe jeton, rr “.....”, i, i gjendjes së mirë ekonomike, ka të kryer, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., posedon nr. tel, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri, i pa dënuar më parë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me dt., rreth orës 14:00 minuta, në rr “P.”, seriozisht e kanos të dëmtuarin N.Z., se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje lidhur me një pronë për të cilën është duke u zhvilluar procedura gjyqësore, i pandehuri Shpëtim i shkruan sms të dëmtuarit N. ku i drejtohet me fjalët kanosëse “Po ta boj te kjart edhe une që nëse nuk e terhek deri te ejten at pshtjellim ne gjykate dhe ne komune, ti personalisht, vllaznit apo kush do që eshte i kyqun do ta paguani shtrejt dhe pa as nje kompromis” si dhe fjalët “nëse nuk e terhek nga gjykata, jo që ke me pas mundësi me marr 1 metër nga prona jeme por as nga pasuria jote ne Prishtine apo ku e ke nuk ka me tvyft”, ashtu që i dëmtuari duke e ndjerë vetën të frikësuar lajmëron rastin në Polici.

- me këtë ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 43, 69, 70, nenit 181 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 365, 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, 450, 452 par.1 dhe 462 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin Shpëtim Smajli e:

GJYKON

- I. DËNIM ME GJOBË** shumën në lartësi prej **një mijë (1000) euro**, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 paragrafi 3 i KPRK-së mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku 20 € (njëzet euro) gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.
- III.** I pandehuri obligohet të paguajë e shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30), në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.
- IV.** I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej njëzetë (20) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.
- V.** I dëmtuari N. Z., me vendbanim në P. në D., udhëzohet që të kërkesën pasurore juridike të realizojë në kontest të rregullt juridiko-civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.1939/20, të dt. 12.11.2020, kundër të pandehurit Shpëtim (D.) Smajli nga P., me vendbanim në rr. ".....", për veprën penale “Kanosja” nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së gjykata me datë 20.09.2023, ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurin Shpëtim Smajli, dhe i dëmtuari N. Z., e në të cilën gjyqtarja e ka ndërprerë procedurën për të referuar çështjen në procedurën e ndërmjetësimit e pas pëlqimit të palëve dhe miratimit të prokurorit të shtetit.

Pasi që ka arritur raporti i dështimit të arritjes së marrëveshjes në procedurën e ndërmjetësimit, gjykata ka caktuar përsëri seancën e shqyrtimit fillestar ku i pandehuri Shpëtim Smajli u deklarua i pafajshëm.

Brenda afatit ligjor, i pandehuri ka parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, për të vilën gjykata me Aktvendim P.nr. 3808/20, të dt. 11.09.2024, ka refuzuar kërkesën e tillë.

Me datë 11.02.2025, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në praninë e prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit Shpëtim Smajli dhe të dëmtuarit N. Z.

Gjykata konform nenit 319 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 321 të KPPRK-se, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me aktakuzën ashtu që i është dhënë mundësia që të pranoj apo mos të pranoj fajësinë.

I pandehuri Shpëtim Smajli deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse ky pranim fajësie është bërë në mënyrë të vetëdijshme dhe pa ndikim nga ana e askujt si dhe në përputhje me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

I dëmtuari Nebih Zariqi deklaroi se nuk pajtohet me pranimin e fajësisë.

Gjykata konform nenit 322 e lidhur me nenin 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve, e ka miratuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në provat materiale nga shkresat e lëndës respektivisht aktakuza siç janë: Raporti, Policit G. K., Deklarata e të dëmtuarit N. Z.e dhënë në Polici me dt. 29.09.2020, Deklarata e të pandehurit Shpëtim Smajli e dhënë në Polici me dt. 29.09.2020, Si dhe foto dokumentacioni i sms.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se meqenëse i pandehuri në fillim të seancës së shqyrtimit kryesor e pranoi fajësinë për veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.1 të KPRK-se dhe bazuar në provat e bashkangjitura në aktakuzë konsideroi se mbetet e pakontestueshme gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës për çka edhe mbeti në tërësi pran saj, ku dhe kërkoi nga gjykata që ndaj të pandehurit të shpall aktgjykim fajësues dhe t'i shqiptoj një dënim meritor siç përcakton KPRK. Ndërsa, me rastin e matjes së dënimit si

rrethanë rënduese i propozoi gjykatës që të merr parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm, ndërsa rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

I dëmtuari N. Z. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi që nga dita kritike nuk kanë pasur asnjë kontakt dhe asnjë problem tjetër, heqi dore nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike dhe se nuk e ndjen vetën të rrezikuar e as të frikësuar.

I pandehuri Shpëtim Smajli në fjalën përfundimtare i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, me këtu të dëmtuarin janë takuar disa herë në zyrën e tij në prezencë edhe të babit të tij. Mesazhi ka qenë i pa qëllimshëm, i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe premtoi se më nuk do ta përsëris.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar edhe në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Shpëtim Smajli, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, dhe nuk ka rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit ngase i njëjti është e vetëdijshëm për veprën e kryer penale e ka kryer me dashje prandaj është penalisht përgjegjëse.

Gjykata, duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata morri parasysh pranimin e fajësisë, raportet e me të dëmtuarin

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit. Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 462 të KPPRK-së, gjykata e udhëzoi palën e dëmtuar N. Z., me vendbanim në P. në D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal
P.nr.808/2020, me datë 25.02.2025

Praktikanti gjyqësor

Gjyqtare e vetme gjykuese

Dardan Tolaj

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.